

UDHËZIM
Nr. 12, datë 15.9.2020

PËR RREGULLAT PËR NJOHJEN E ZONAVE TË PASTRA

(ndryshuar me udhëzimin nr. 15, datë 19.11.2020)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”,

UDHËZOJ:

1. Një parazit karantinor, në lidhje me një territor të përcaktuar, është paraziti karantinor që plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) identiteti i tij është vendosur sipas kriterëve të mëposhtme:

i. identiteti taksonomik i parazitit të përcaktohet qartë, përndryshe paraziti do të tregojë simptoma të qëndrueshme dhe do të jetë i transmetueshëm;

ii. identiteti taksonomik i parazitëve të përcaktohet në nivelin e specieve ose në mënyrë alternative, një nivel taksonomik më të lartë ose më të ulët, kur ai nivel taksonomik është shkencërisht i përshtatshëm, bazuar në virulencën, gamën e pritësit ose marrëdhëniet e vektorit;

b) nuk është i pranishëm në territor, në kuptimin që paraziti nuk dihet të jetë i pranishëm në territorin e interesuar ose nëse është i pranishëm nuk është shpërndarë gjerësisht brenda këtij territori, në kuptimin:

i. paraziti nuk dihet se është i pranishëm në territorin e interesuar, përveç në një pjesë të kufizuar të tij;

ii. paraziti nuk dihet të jetë i pranishëm në territorin e interesuar, përveç prezencës së pakët, të çrregullt, të izoluar dhe të rrallë në të.

Kur plotësohet kushti i shkronjës “b”, nënparagrafët “i” ose “ii”, paraziti do të konsiderohet se nuk është gjerësisht i shpërndarë;

c) është i aftë të hyjë, të vendoset dhe të përhapet brenda territorit ose nëse është i pranishëm por jo gjerësisht i shpërndarë, është i aftë të hyjë, të vendoset brenda dhe të përhapet brenda atyre pjesëve të atij territori ku mungon.

Paraziti konsiderohet i aftë për të hyrë në territorin e interesuar apo nëse është i pranishëm por jo gjerësisht i shpërndarë, në pjesën e territorit ku mungon, “pjesa përkatëse e zonës së rrezikuar” ose nga përhapja natyrore ose nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. shoqërohet, për sa u përket bimëve, produkteve bimore ose objekteve të tjera që janë zhvendosur në territorin e interesuar me ato bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera në territorin nga kanë origjinuar ose nga ku janë zhvendosur në territorin e interesuar;

ii. mbijeton gjatë transportit ose ruajtjes;

iii. mund të transferohet në një bimë të përshtatshme pritëse, produkt bimor ose objekt tjetër në territorin e interesuar.

Paraziti konsiderohet i aftë për t’u “vendosur” në territorin e interesuar ose nëse është i pranishëm, por jo gjerësisht i shpërndarë, në pjesën e territorit ku mungon, nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

i. bartësit e parazitit dhe kur është e përshtatshme, vektorët për transmetimin e parazitëve janë të disponueshëm;

ii. faktorët vendorë të mjedisit janë të favorshëm për parazitin e interesuar dhe kur është e përshtatshme vektori i tij, duke i mundësuar të mbijetojë periudha të stresit klimatik dhe të përfundojë ciklin e tij të jetës;

iii. praktikat e kultivimit dhe masat e kontrollit të aplikuara në atë territor janë të favorshme;
iv. metodat e mbijetesës, strategjia riprodhuese, përshtatshmëria gjenetike e parazitëve dhe madhësia minimale e popullatës së shëndetshme mbështesin krijimin e tij.

Paraziti konsiderohet i aftë për përhapje territoriale në territorin e interesuar ose nëse është i pranishëm por jo gjerësisht i shpërndarë në pjesën e territorit ku mungon, nëse plotësohet një ose më shumë nga kushtet e mëposhtme:

i. mjedisi është i përshtatshëm për përhapjen natyrale të parazitëve;
ii. pengesat për përhapjen natyrale të parazitëve janë të pamjaftueshme;
iii. lënda e parë ose mjetet e transportit lejojnë lëvizjen e parazitëve;
iv. bartësit dhe kur është e përshtatshme, vektorët e parazitëve janë të pranishëm;
v. praktikat e kultivimit dhe masat e kontrollit të aplikuara në atë territor janë të favorshme;
vi. armiqtë natyrorë dhe antagonistët e parazitëve nuk janë të pranishëm ose jo aq të aftë për të shtypur parazitin;

ç. hyrja, vendosja dhe përhapja e parazitëve në territorin e interesuar ose nëse është i pranishëm por jo gjerësisht i shpërndarë, në pjesën e territorit ku mungon do të ketë një ndikim ekonomik, social dhe/ose mjedisor të papranueshëm në atë territor ose në atë pjesë të territorit ku nuk është gjerësisht i shpërndarë, në lidhje me një ose më shumë nga pikat e mëposhtme:

i. humbje e të korrave për sa i përket rendimentit dhe cilësisë;
ii. kosto të masave të kontrollit;
iii. kostot e rimbjelljes dhe/ose e humbjeve, për shkak të domosdoshmërisë së rritjes së bimëve zëvendësuese;

iv. efektet në praktikat ekzistuese të prodhimit;
v. efektet në pemët e rrugës, parqet dhe zonat natyrore dhe të mbjella;
vi. efektet në bimët vendëse, biodiversitetin dhe shërbimet e ekosistemit;
vii. efektet në krijimin, përhapjen dhe ndikimin e parazitëve të tjerë, për shembull, për shkak të aftësisë së parazitëve të interesuar për të vepruar si vektor për parazitët e tjerë;

viii. ndryshimet në kostot e prodhuesit ose kërkesat për inpute, përfshirë kostot e kontrollit dhe kostot e çrrënjësjes dhe mbajtjes;

ix. efektet në fitimet e prodhuesit që vijnë nga ndryshimet në cilësi, kostot e prodhimit, rendimentet ose nivelet e çmimeve;

x. ndryshimet në kërkesën e konsumatorit vendës ose të huaj për një produkt që vjen nga ndryshimet e cilësisë;

xi. efektet në tregjet vendëse dhe ato të eksportit;

xii. burimet e nevojshme për kërkime dhe këshilla shitesë;

xiii. efektet mjedisore dhe efekte të tjera të padëshiruara të masave të kontrollit;

xiv. efektet në zona të tjera të pastra;

xv. ndryshimet në proceset dhe strukturën ekologjike, stabilitetin ose proceset e një ekosistemi, përfshirë efektet e mëtejshme në speciet bimore, erozionin, ndryshimet e ujit, rreziqet e zjarrit dhe ciklit ushqyes;

xvi. kostot e rigjenerimit të mjedisit dhe masave parandaluese;

xvii. efektet në sigurimin e ushqimit dhe sigurinë ushqimore;

xviii. efektet në punësim;

xix. efektet në cilësinë e ujit, argëtimin, turizmin, trashëgiminë e peizazhit, kullotat e kafshëve, gjuetinë, peshkimin;

d) masa të mundshme dhe efektive të jenë në dispozicion për të parandaluar hyrjen, vendosjen ose përhapjen e këtij paraziti brenda këtij territori dhe për të zvogëluar rreziqet dhe ndikimin e tij.

2. Kur një parazit karantinor është i pranishëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, por nuk është i pranishëm në territorin e një rajoni ose një pjese të tij dhe nuk është një parazit karantinor i

territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me përcaktimet e pikës 4 të këtij udhëzimi, ky territor ose një pjesë e tij njihet si zonë e pastër, në lidhje me parazitin karantinor, “paraziti karantinor i zonës së pastër”, sipas përcaktimit të pikës 3 të këtij udhëzimi.

3. Një parazit karantinor i zonës së pastër nuk duhet të futet, të lëvizë brenda ose të mbahet, shumëzohet ose lëshohet në zonën përkatëse të pastër.

4. Struktura Përgjegjëse për Mbrojtjen e Bimëve (SPMB) në ministri mban një listë të zonave të pastra dhe parazitëve përkatës karantinor të këtyre zonave të pastra. Kjo listë përfshin zonat e pastra të njohura në përputhje me këtë udhëzim, parazitët përkatës të listuar në seksionin II, të aneksit I dhe seksionin II, të aneksit II, të vendimit nr. 750, datë 14.7.2010, “Për miratimin e rregullave të inspektimit karantinor fitosanitar” dhe kodet që iu atribuohen posaçërisht këtyre parazitëve.

5. Një zonë e pastër miratohet nga ministri pas paraqitjes nga SPMB-ja të dosjes që përmban:

- a) një përshkrim të kufijve të zonës së pastër të propozuar, duke përfshirë hartat;
- b) rezultatet e monitorimit që tregojnë se, të paktën gjatë tre vjetëve para paraqitjes së dosjes, paraziti karantinor i interesuar nuk është i pranishëm në territorin përkatës; dhe
- c) prova që paraziti karantinor i plotëson kushtet e përcaktuara në pikën 1, në lidhje me zonën e pastër të propozuar.

6. Monitorimet sipas shkronjës “b”, të pikës 5, të bazohen në parime të shëndosha shkencore dhe teknike, të kryhen në momente të përshtatshme dhe të jenë me intensitetin e duhur, në lidhje me mundësinë e zbulimit të parazitëve të interesuar. Plani i monitorimeve përgatitet nga SPMB-ja në bashkëpunim me Departamentin e Mbrojtjes së Bimëve në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë (ISUV) dhe bazohet në rrezikun e shfaqjes së parazitit në zonën e mbuluar në çdo monitorim. Monitorimet duhet të përmbajnë, të paktën, kontrole vizuale nga Shërbimi Rajonal i Mbrojtjes së Bimëve dhe, kur është e përshtatshme, marrjen e mostrave dhe kryerjen e testeve. Këto monitorime do të bëhen në të gjitha mjediset e duhura dhe përfshijnë ambientet, automjetet, makineritë dhe paketimet e përdorura nga operatorët e biznesit në këtë fushë. Këto monitorime do të marrin në konsideratë provat shkencore dhe teknike dhe çdo informacion tjetër të duhur, lidhur me praninë e parazitëve të interesuar.

7. Ministri njeh edhe zona të përkohshme të pastra, për këtë qëllim, kushtet e përcaktuara në pikat 2, 5 dhe 6 do të zbatohen plotësisht. Duke mos marrë në konsideratë kërkesën e përmendur në shkronjën “b”, të pikës 5, realizohet një monitorim për një periudhë të paktën një vit përpara paraqitjes së dosjes për miratim. Njohja e një zone të pastër të përkohshme do të zgjasë jo më shumë se tre vjet pas njohjes dhe skadon automatikisht pas tre vjetësh.

8. Detyrimet në lidhje me një zonë të pastër përfshijnë:

a) personat fizikë dhe juridikë, që kultivojnë, prodhojnë, përpunojnë, magazinjnë dhe tregtojnë bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera, duhet të njoftojnë menjëherë Shërbimin Rajonal të Mbrojtjes së Bimëve për çdo provë që ata mund të kenë në lidhje me një rrezik të afërt për parazitin karantinor;

b) Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve në ISUV konfirmon zyrtarisht praninë e një paraziti karantinor;

c) SPMB-ja informon operatorët e biznesit me aktivitet në fushën e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera për parazitin karantinor;

ç) SPMB-ja ndërmerr menjëherë veprimet e duhura për zbatimin e masave të përshtatshme. Kur është e mundur, operatori i biznesit me aktivitet në fushën e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, gjithashtu merr menjëherë masa paraprake për të parandaluar vendosjen dhe përhapjen e këtij paraziti;

d) persona të ndryshëm nga operatorët e biznesit me aktivitet në fushën e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, kur janë të vetëdijshëm për praninë e një paraziti karantinor ose kanë arsye të dyshojnë për një prani të tillë, njoftojnë menjëherë Shërbimin Rajonal të Mbrojtjes së Bimëve.

Kur ky njoftim nuk është bërë me shkrim, Shërbimi Rajonal i Mbrojtjes së Bimëve, mban procesverbal dhe e regjistron atë zyrtarisht. Këta persona duhet t'i sigurojnë Shërbimit Rajonal të Mbrojtjes së Bimëve, informacionin që disponojnë në lidhje me praninë e dëmtuesit;

dh) kur konfirmohet zyrtarisht një nga rastet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 1, Shërbimi Rajonal i Mbrojtjes së Bimëve krijon menjëherë një ose më shumë zona ku do të merren masat e çrrënjësjes së dëmtuesit. Këto zona do të quhen “zonë e demarkuar”. Zona e demarkuar përbëhet nga një zonë e infektuar dhe një zonë e sigurisë ose tampon, e cila është një zonë përreth ose ngjitur me zonën e infektuar dhe shërben për të minimizuar mundësinë e përhapjes së parazitit të interesuar në/ose jashtë zonës së infektuar dhe u nënshtrohet masave fitosanitare ose kontrolleve të tjera, nëse është e nevojshme. Shërbimi Rajonal i Mbrojtjes së Bimëve, të paktën një herë në vit, në momente të përshtatshme, kryen një monitorim të secilës zonë të demarkuar, në lidhje me zhvillimin e pranisë së parazitëve të interesuar.

9. Një bimë, produkt bimor ose një objekt tjetër me origjinë në një zonë të demarkuar, të krijuar në një zonë të pastër, për parazitët karantinorë të zonës së pastër, nuk do të lëvizë nga kjo zonë e demarkuar në pjesën e mbetur të asaj zone të pastër ose në ndonjë zonë tjetër të pastër, të krijuar për atë parazit karantinor të zonës së pastër. Në përjashtim nga paragrafi i mësipërm, bima, produkti bimor ose objekti tjetër mund të lëvizë jashtë zonës së demarkuar përmes dhe jashtë zonës së pastër të interesuar, vetëm nëse është e pakëtuar dhe lëviz në atë mënyrë që nuk ekziston rreziku i përhapjes së parazitëve karantinorë të zonës së pastër, brenda asaj zone të pastër.

10. Shërbimi Rajonal i Mbrojtjes së Bimëve kryen monitorime vjetore të secilës zonë të pastër, në lidhje me praninë e parazitëve karantinorë të zonës së pastër të interesuar, duke zbatuar të gjitha përcaktimet e pikës 6 të këtij udhëzimi.

11. Ministri mund të ndryshojë shtrirjen e një zone të pastër në bazë të dosjes së aplikimit të paraqitur nga SPMB-ja. Kur ky ndryshim ka të bëjë me zgjerimin e një zone të pastër, zbatohen të plota përcaktimet e pikave 2 deri në 7.

12. Me kërkesë të SPMB-së, ministri shfuqizon njohjen e një zone të pastër ose zvogëlon shtrirjen e saj.

13. Shfuqizimi i njohjes së një zone të pastër bëhet, nëse:

- a) monitorimet nuk janë kryer në përputhje me përcaktimet në pikën 6 të këtij udhëzimi;
- b) paraziti përkatës karantinorë i zonës së pastër është konstatuar se është i pranishëm në atë zonë dhe përmbush një nga kushtet e mëposhtme:
 - i. asnjë zonë e demarkuar nuk është krijuar brenda tre muajve nga konfirmimi zyrtar i pranisë së këtij paraziti;
 - ii. masat e çrrënjësjes të marra në një zonë të demarkuar, nuk kanë qenë të suksesshme brenda 24 muajve nga konfirmimi zyrtar i pranisë së atij paraziti, ose brenda një periudhe më të gjatë se 24 muaj, kur biologjia e parazitit e justifikon këtë;
 - iii. informacioni në dispozicion tregon mosveprim ndaj pranisë së këtij paraziti në zonën e pastër të interesuar.

13/1. Rregullat për lëvizjen e bimëve, të produkteve bimore dhe objekteve të tjera brenda dhe ndërmjet zonave të pastra, përcaktohen si më poshtë:

a) Shërbimi Rajonal i Mbrojtjes së Bimëve të garantojë që kushtet e lëvizjes, të përcaktuara në shkronjën “b” të kësaj pike, të plotësohen për bimët, produktet bimore ose objektet e tjera të listuara në pjesën A, në aneksin V, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 14.7.2010 “Për miratimin e rregullave të inspektimit karantinor fitosanitar”, që përbëjnë rrezik për bartjen e një ose disa prej parazitëve të caktuar, me origjinë jashtë një zone të pastër të miratuar, që lëvizin nga zona të tjera drejt zonës së pastër me destinacion përfundimtar jashtë kësaj zone.

b) Për lëvizjen e bimëve, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. paketimin dhe/ose mjetet e transportit kur është e përshtatshme, të përdorura për transportin e bimëve, produkteve bimore ose objektet e tjera, të përcaktuara në shkronjën “a”, të kësaj pike, duhet të jenë të pastër nga parazitët e referuar

në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 750, datë 14.7.2010 “Për miratimin e rregullave të inspektimit karantinor fitosanitar” dhe të përshtatshëm për të siguruar mospërhapjen e këtyre parazitëve gjatë gjithë kohës së lëvizjes nëpër zonën e pastër përkatëse;

ii. menjëherë pas plotësimit të paragrafit më lart në dokumentet shoqëruese të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, të përcaktuara në shkronjën “a”, të kësaj pike, duhet të jenë pasqyruar qartë vendi i origjinës dhe destinacioni i tyre;

iii. bimët, produktet bimore ose objektet e tjera të përmendura në shkronjën “a”, të kësaj pike, do të shoqërohen me një dokument i cili zakonisht përdoret për qëllime tregtare, duke treguar që produktet e përmendura e kanë origjinën jashtë zonës të pastër dhe të ketë një destinacion jashtë zonës së pastër përkatëse.

13/2. Nëse gjatë kryerjes së kontrollit fitosanitar brenda zonës së pastër, konstatohen mospërmbushje të kërkesave të pikës 13/1, të këtij udhëzimi, veprimtaria që është duke u kryer, e parashikuar më sipër, ndalohet menjëherë dhe merren masat e mëposhtme:

- vulosja e paketimit;

- transportimin, nën kontrollin e Shërbimit Rajonal të Mbrojtjes së Bimëve e bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera, në një destinacion jashtë zonës së pastër përkatëse.

14. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe e Përputhshmërisë në Bujqësi, Ushqim dhe Zhvillim Rural, Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Bledar Çuçi